



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.**
Nr. Dok. 201502254/4

Tiranë ____/____/2016

Lënda: *Rekomandohet marrja e masave të menjëhershme për përmbushjen e detyrimit sikurse vendosur me Vendimin Gjyqësor të formës së prerë nr. 2918, datë 12.12.2006, prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Durrës.*

Drejtuar : **Drejtorit të Kapitenerisë së Përgjithshme të Portit**
Z.Edmond Doraci

DURRES

Për dijeni : **R.T.**
Adresa:

DURRES

Z.Drejtor i Përgjithshëm!

Institucioni i Avokatit të Popullit ka pranuar për shqyrtim ankesën e shtetases R.T., në të cilën ajo ka prezantuar shqetësimin për mospërmbushjen nga ana e organit që ju përfaqësoni të detyrimit të vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Durrës, me Vendimin Gjyqësor civil të formës së prerë nr. 2918, datë 12.12.2006, të dhënë prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Durrës, lënë në fuqi me Vendimin nr. 540, datë 03.12.2007, nga Gjykata e Apelit, Durrës, për të cilin është lëshuar dhe urdhëri i ekzekutimit me Vendimin nr. 36 Akti, datë 21.01.2008, me objekt :

"Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të zgjidhjes së kontratës së punës mes Kapitenerisë së Përgjithshme të Porteve dhe kërkueses, detyrimin e rikthimit në punë të kërkueses dhe të pagimit të saj për gjithë periudhën e qëndrimit pa punë, duke filluar nga data 31.05.2006 e deri në ekzekutimin e vendimit gjyqësor".

Për detyrimin e vendosur sipas vendimit gjyqësor të lartpërmendur, janë kryer një numër i konsiderueshëm veprimesh prej autoriteteve shtetërore përgjegjëse, të cilat, edhe pse nuk kanë pasur asnjë pengesë ligjore nuk kanë bërë të mundur ekzekutimin e këtij vendimi gjyqësor të formës së prerë.

Kjo situatë e parregullt dhe në cënim të së drejtës së ankueses është konstatuar nga Gjykata Kushtetuese me rastin e dhënies së Vendimit nr. 4, datë 20.02.2013, sipas të cilit është vendosur për :

“Konstatimin e cënimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.540, datë 03.12.2007 i Gjykatës së Apelit, Durrës”.

Më tej, konstatohet se, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), lidhur me kërkesë ankesën nr. 38964/2013, të depozituar prej zj.Rajmonda Trupja, në përfundim të gjykimit ka vendosur për konstatimin e cënimit të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor, sikurse sanksionuar në nenin 6/1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Në zbatim të vendimit të dhënë prej GJEDNJ, Këshilli i Ministrave me Vendimin nr. 650, datë 22.07.2015, ka vendosur për ekzekutimin e tij, duke përcaktuar midis të tjerëve dhe Kapitenerinë e Përgjithshme të Porteve, Durrës, si subjekt i cili duhet të përmbush detyrimet e vendosura.

Në procesin e ekzekutimit të Vendimit Gjyqësor të formës së prerë nr. 540, datë 03.12.2007, qëndrimi i organit që ju përfaqësoni nuk duhet të çënoi marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, të cilat sigurojnë jo vetëm veprimtarinë e rregullt të organit por dhe mbrojtjen e interesave të ligjshme të shtetasve apo të shtetit, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni në fuqi.

Edhe pse kanë kaluar më shumë se nëntë vjet, nga marrja formë të prerë e vendimit gjyqësor si dhe marrja dijeni e lajmërimit për përmbushjen e detyrimit në mënyrë vullnetare, prej Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor, ende nuk është bërë e mundur ekzekutimi i tij. Ky qëndrim, është vlerësuar prej Gjykatës Kushtetuese si dhe vlerësohet prej Institucionit të Avokatit të Popullit, në kundërshtim me sanksionimin e nenit 142/3 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, në të cilin parashikohet se :

“Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore”, nenin 451/a të K.Pr.C, se : “Vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët, për trashëgimtarët e tyre, për personat që heqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera...”

si dhe me parimet mbi të cilat zhvillohet veprimtaria e Organeve të Administratës Publike, të sanksionuara në Kodin e Procedurës Administrative dhe të detyrueshme në kuptim dhe zbatim të nenit 1 të këtij Kodi.

Në këtë kuadër, do të vinim theksin në faktin, se, angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë po bëhen gjithnjë dhe më konkrete, sidomos në planin e të drejtave të njeriut, të zbatimit të akteve juridike ndërkombëtare dhe të integritetit evropian. Do të ishte cënim i rëndë i autoritetit të shtetit, nëse ankuesi do t'i drejtohej Gjykatës së Strasburgut kundër Shtetit Shqiptar, për një të drejtë të kësaj natyre, ndërkohë që Qeveria në programin e saj e ka konsideruar problem të mprehtë dhe është angazhuar për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Gjithashtu, Parlamenti Evropian në miratimin e rezolutës për Shqipërinë datë 08.07.2010, kujton autoritetet në Shqipëri se një nga kushtet e integritetit në BE është reforma në gjyqësor, përfshi zbatimin e vendimeve gjyqësore.

Gjykata e Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në praktikën e saj të vazhdueshme ka theksuar se shteti duhet të marrë përsipër vazhdimisht detyrimin për të siguruar palët pjesëmarrëse në proces se do të kenë mundësi reale të ekzekutojnë vendimin gjyqësor të formës së prerë dhe se e drejta për të pasur akses në gjykatë do të ishte iluzion nëse sistemi ligjor dhe zbatimi i tij në praktik do të bëhej shkak që një vendim gjyqësor i formës së prerë të mbetej joefektiv dhe i pazbatueshëm për një kohë tepër të gjatë. Në fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësish, pala debitore që ju përfaqësoni duhet të marrë pjesë aktivisht në ekzekutimin e detyrimeve.

Gjykata Kushtetuese Shqiptare në vendimmarrjet e saj ka pranuar se :

“... parimet kushtetuese lidhur me procesin e rregullt ligjor, për të cilin bën fjalë neni 42/2 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së si dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të parashikuara në nenin 142/3 të Kushtetutës, nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pakufi për realizimin e saj”.

Më tej,

“...ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre”.

Në situatën juridike në të cilën ndodhet çështja, Avokati i Popullit, nisur nga parimi i zbatimit të ligjshmërisë, rritjes së efektivitetit në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si dhe për një zgjidhje ligjore të këtij problemi e çmon me vend të bëjë këtë rekomandim, duke shpresuar se, kështu, do të ndihmojmë bashkërisht për vënien në vend të së drejtës të shkelur ankuses në fjalë.

Për të gjitha këto arsye, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në të cilin thuhet se : *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”*, si dhe nenin 21/b të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, i cili parashikon se : *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”*,

Për të gjitha këto arsye, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin sanksionohet se :

“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata Publike”, si dhe nenit 21/b, se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”*,

REKOMANDOJMË

Marrjen e masave të menjëhershme për përmbushjen e detyrimeve sikurse vendosur me Vendimin Gjyqësor civil të formës së prerë nr. 2918, datë 12.12.2006, të dhënë prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Durrës.

Në përfundim të shqyrtimit të rekomandimit të dhënë, konform nenit 19 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, kthimi përgjigjes duhet të kryhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

Duke besuar në bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONERI

Etilda GJONAJ(SALIU)

Konceptoi dhe Daktiligrafoi
A.Gjoleka